

**VENDIM**  
**Nr.563, datë 3.8.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 23.3.2000 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE**  
**PËRLLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE QË**  
**SHPRONËSOHEN, TË PASURIVE QË ZHVLERËSOHEN DHE TË TË**  
**DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRETË, PËR INTERES PUBLIK”, TË**  
**NDRYSHUAR**

*(Ndryshuar me VKM nr. 560, datë 22.8.2012)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit të 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Përgjashtimisht, për investimet në akse rrugore kombëtare, shpronësohen edhe zotëruesit privatë të objekteve/pasurive të paluajtshme të përgjistruara në regjistrat publikë të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Enti që bën shpronësimin, ka të drejtë të kryejë procedurat e shpronësimit ndaj zotëruesve të këtyre pasurive, pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

a) Zotëruesit e objektit janë në proces administrativ pranë ALUIZNI-t sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar;

b) Ndërtimi pa leje ose shtesa pa leje, që zotëron subjekti që shpronësohet, gëzon statuset e vetëdeklaruar e i kualifikuar më parë për leje legalizimi nga ALUIZNI, sipas të gjitha kriterëve të vendimit nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, të ndryshuar;

c) Zotëruesit e objektit janë në proces për t’u pajisur me leje legalizimi pasi:

i) disponohet një akt i Këshillit të Ministrave, i botuar në Fletoren Zyrtare, në zbatim të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar, që identifikon objektin e tyre dhe këtë subjekt (person fizik/juridik) si zotërues të objektit pa leje apo shtesës pa leje në parcelën ndërtimore; apo

ii) subjekti zotërues ka ngritur objektin në tokë të tij/shtetit dhe nuk është skualifikuar nga procedura e legalizimit.

Procedurat e mësipërme të shpronësimit quhen të kryera nga çasti kur zotëruesi i objektit pa leje apo shtesës pa leje i nënshkruan entit që kryen shpronësimin deklaratën sipas aneksit 1, dhe hyn në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave.

Të gjitha detyrimet ndaj personave të tjerë dhe të tretëve, në lidhje me të drejtat e pronës, zgjidhen nga zotëruesi.

Përgjashtimisht, në zbatim të detyrimeve sipas këtij akti, ALUIZNI qendror, për të

gjitha dosjet e subjekteve vetëdeklaruese, të kualifikuar, sipas paragrafit 1, arkivon me shënim të veçantë dosjen dhe pezullon çdo veprim administrativ të mëtejshëm me marrjen e urdhërimit për pezullim nga ministria e linjës. Këto dosje të ALUIZNI-t arkivohen si praktika të veçanta pas dërgimit nga MPPT-ja të listës së pasurive dhe numrit rendor të subjektit në vendimet respektive të Këshillit të Ministrave dhe janë subjekt depozitimi në Arkivin e Shtetit.”.

2. Përmbajtja e pikës 1 të këtij vendimi zbatohet edhe për kërkesat për shpronësim, të cilat janë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Për këto raste, struktura përgjegjëse që merret me procedurën e shpronësimit autorizohet të përfundojë procedurën, për këtë kategori objektsh, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 1.5.2013.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**